VENDIM
Nr. 33/2022

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT TË POZICIONEVE TË PUNËS SË ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA (ERRU)

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës; të nenit 10, pika 1, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", të ndryshuar, si dhe të nenit 9, pika 1, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, me propozimin e Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU),

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Struktura e ERRU-së është sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur.

II. Organika e ERRU-së është sipas lidhjes nr. 2, bashkëlidhur.

III. Numri i punonjësve është 29.

IV. Vendimi nr. 34/2016, datë 28.4.2016, "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)" shfuqizohet.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 14.4.2022.

STRUKTURA ORGANIZATIVE E ERRU

Lidhja nr.1



ORGANIKA E DETAJUAR E ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA (ERRU)

Lidhja nr. 2

KOMISIONI I ERRU-së	**Kategoria e pagës**	**Numri**
KRYETARI		1
ANËTARË KOMISIONI		4
Sekretarja e Komisionit dhe kryetarit		1
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM	I-b	**1**
DREJTORIA TEKNIKO-EKONOMIKE		**9**
Drejtor drejtorie	II-b	1
Sektori Teknik dhe i Licencave		
Përgjegjës sektori	III-a	1
Specialist i Rrjeteve Inxhinierike të Ujësjellësve dhe ITUP	III-b	1
Specialist i Rrjeteve Inxhinierike të KUN dhe ITUN	III-b	1
Sektori Ekonomik dhe Tarifave		
Përgjegjës sektori	III-a	1
Specialist i Analizës Ekonomiko-financiare	III-b	1
Specialist i Analizës së Aseteve dhe Investimeve	III-b	1
Sektori i Monitorimit dhe Performancës		
Specialist i Performancës Operative dhe Cilësisë së Shërbimit	III-b	1
Specialist i Performancës Ekonomiko-financiare	III-b	1
DREJTORIA JURIDIKE DHE E KONSUMATORIT		**5**
Drejtor drejtorie	II-b	1
Sektori Juridik		
Specialist ligjor	III-b	2
Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Konsumatorin		
Specialist i Trajtimit të Ankesave	III-b	1
Specialist i Marrëdhënieve me Publikun	III-b	1
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		**8**
Drejtor drejtorie	II-b	1
Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Financiare		
Specialist i Burimeve Njerëzore	III-b	1
Specialist Finance	III-b	1
Sektori i Shërbimeve		
Specialist IT	III-b	1
Specialist Protokoll-arkiv	IV-b	1
Punonjës mbështetës		
Shoferë		2
Magazinier dhe sanitare		1
TOTALI		**29**